



MARREVESHJE BASHKPUNIMI

E lidhur dhe nenshkruar ne Prishtine me date 13/10/2025 ne mes te paleve te kesaj merreveshje:

1. **Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN" SH. A.**, me seli ne Prishtine, Rr. Perandori Justinian ,nr.69, ne tekstin e metejme Kompania te cilen e perfaqeson **Z. Hekuran Neziri**.

2. **Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës - OIRK**, me seli ne Prishtine, Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr.3, kati 2, e perfaqesuar nga **Z. Arsim Rapuca (Kryetar)**

Neni 1

Objekti i marreveshjes

Objekti i kesaj marreveshje eshte ofrimi i sigurimit të përgjegjësisë profesionale për inxhinierët të cilët janë anëtarë të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës – OIRK.

Neni 2

Palet u pajtuan se kjo mareveshje do të lidhet permes Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës – OIRK duke sherbyer si ndermjetesues per inxhinierët të cilët janë anëtarë të Odës.

OIRK është marrë me procesin e perzgjedhjes se ofruesit te sherbimeve të sigurimit ne llogari te inxhinierëve anëtar.

Neni 3

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale për inxhinierët anëtarë të OIRK, do te ofrohet ne dy forma/mundesi:

- * **Police sigurimi një vjeçare (3 opsione per zgjedhje te limitit te mbulimit)**
- * **Police sigurimi pesë vjeçare (3 opsione per zgjedhje te limitit te mbulimit)**

Neni 4

Palet u pajtuan se ne kuader te kesaj marreveshje do të ceken te gjitha specifikat teknike që do të shërbejne mbarevajtjen e procesit të kontraktimit të policave.



Policat e sigurimit do te perгатiten ne menyre individuale per secilin nga inxhinieret anetare te OIRK, sipas procedures me poshte:

1. Paraqitja e kerkeses ne forme fizike prane rrjetit te zyreve tona ne qytetet e Kosovës, apo duke derguar kerkesen ne njerin nga e-maillet:
marigona.hasani@scardian.com
albanina.nimanaj@scardian.com
leonora.demaj@scardian.com
2. Licenca:
 - a) Nese kerkesa behet ne forme fizike: kopja fizike e licences
 - b) Nese kerkesa behet ne forme elektronike: kopja e licences te dergohet me e-mail.
3. Dëshmia për anëtarësim ne OIRK.
4. Perzgjedhet njera nga mundesite per sigurim dhe opsioni i limitit te mbulimit.
5. Faturimi behet individualisht ne emer te secilit inxhinier anetar.

Neni 5

Kjo marreveshje lidhet ne kohe te caktuar dhe do te vlejje per periudhen **13.10.2025-12.10.2026**.

Neni 6

Kjo mareveshje eshte perpiluar ne 2 kopje identike, nga nje per ofruesin dhe ndermjetesuesin e sherbimeve.

Kompania e Sigurimeve

“SCARDIAN” SH. A.

Hekuran Neziri



**Oda e Inxhinierëve të Republikës
së Kosovës - OIRK**

Arsim Rapuca



SHTOJCA 1

- **Ofertat e sigurimit**
- **Kushtet e sigurimit**

09.06.2025, Prishtine

Për: ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SE KOSOVËS
Nga: SCARDIAN Sigurime
Lënda: Ofertë për Sigurimin e Përgjegjësisë profesionale
Validiteti i Ofertës: 30 ditë

Të nderuar,

Scardian Sigurime, ashtu siç tregon simboli ynë, është kompani e besueshme, mbrojtëse, e kujdesshme dhe e përkushtuar ndaj atyre që na mundëson ekzistencën, pra klientëve tanë.

Jemi licencuar me datë 09 Shkurt, 2015 nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e të gjitha llojeve të sigurimeve prezentë në tregun Kosovarë. Jemi prezent në të gjitha qytetet e Kosovës dhe në gatishmëri për klientët tanë në çdo kohë.

Qëllimi ynë është të minimizojmë traumat dhe shpenzimet e klientëve tanë në rast fatkeqësie. Mundohemi që t'u ndihmojmë klientëve të vazhdojnë përditshmërinë sa më shpejtë pas ndodhjes së ngjarjes së siguruar.

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE

Polica e sigurimit të Përgjegjësisë është dizajnuar për të mbuluar dëmet të cilat mund ti shkaktoni ju personalisht, apo punëtorët e kompanisë tuaj. Sigurimi i përgjegjësisë mund të mbulojë: përgjegjësinë profesionale, përgjegjësinë e produktit, përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Opsioni i I-rë:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	20,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHME	10% EUR
PRIMI	18.00 EUR
TVSH	3.24 EUR
NË TOTAL:	21.24 EUR

Opsioni i II-të:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	50,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHME	10% EUR
PRIMI	45.00 EUR
TVSH	8.10 EUR
NË TOTAL:	53.10 EUR

Opsioni i III-të:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	100,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHME	10% EUR
PRIMI	90.00 EUR
TVSH	16.20 EUR
NË TOTAL:	106.20 EUR

Shënim:

* Periudha e sigurimit është një vjeçare (pa mbulim retroaktiv)

** Të gjitha mbulimet i nënshtrohen limiteve, kushteve dhe përjashtimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit. Të gjitha kompensimet u nënshtrohen kushteve dhe përjashtimeve.

KLAUZOLA E MBULIMEVE:

- Gabime në projektim (errors)
- Përjashtime apo lëshime në përgatitjen e dokumentacionit teknik (omissions)
- Neglizhencë profesionale gjatë mbikëqyrjes apo zbatimit të punimeve
- Shkelje të standardeve teknike që sjellin pasoja financiare apo dëme për palët e treta

KLAUZOLA E PERJASHTIMEVE:

- Veprime të qëllimshme apo mashtruese
- Dëme që rrjedhin nga veprimtari jashtë fushës së licencës
- Ndërtime pa leje ose në shkelje të ligjit
- Projekte të jashtme që nuk janë të deklaruar në fillim të policës
- Përgjegjësi penale (sigurimi mbulon vetëm aspekte civile/financiare)

Kërkesa për dëmshpërblim duhet të bëhet brenda periudhës aktive të policës, edhe nëse gabimi ka ndodhur më herët. Pra, polica nuk ofron mbulim retroaktiv.

Për t'u informuar në detaje rreth mbulesës siguroese apo për informata shtesë rreth produkteve të SCARDIAN Sigurime, ju lutemi të na kontaktoni.

Që oferta të jetë valide, klienti duhet të:

Faleminderit në bashkëpunim !

Me respekt,
SCARDIAN Sigurime



09.06.2025, Prishtine

Për: ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SE KOSOVËS
Nga: SCARDIAN Sigurime
Lënda: Ofertë për Sigurimin e Përgjegjesisë profesionale
Validiteti i Ofertës: 30 ditë

Të nderuar,

Scardian Sigurime, ashtu siç tregon simboli ynë, është kompani e besueshme, mbrojtëse, e kujdesshme dhe e përkushtuar ndaj atyre që na mundëson ekzistencën, pra klientëve tanë.

Jemi licencuar me datë 09 Shkurt, 2015 nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e të gjitha llojeve të sigurimeve prezentë në tregun Kosovarë. Jemi prezent në të gjitha qytetet e Kosovës dhe në gatishmëri për klientët tanë në çdo kohë.

Qëllimi ynë është të minimizojmë traumat dhe shpenzimet e klientëve tanë në rast fatkeqësie. Mundohemi që t'u ndihmojmë klientëve të vazhdojnë përditshmërinë sa më shpejtë pas ndodhjes së ngjarjes së siguruar.

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE

Polica e sigurimit të Përgjegjesisë është dizajnuar për të mbuluar dëmet të cilat mund të shkaktoni ju personalisht, apo punëtorët e kompanisë tuaj. Sigurimi i përgjegjesisë mund të mbulojë: përgjegjësinë profesionale, përgjegjësinë e produktit, përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Opsioni i I-rë:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	20,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHME	10% EUR
PRIMI	88.98 EUR
TVSH	16.01 EUR
NË TOTAL:	106.20 EUR

Opsioni i II-të:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	50,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHME	10% EUR
PRIMI	220.34 EUR
TVSH	39.66 EUR
NË TOTAL:	260.00 EUR



Opsioni i III-të:

SIGURIMI I PËRGJEGJESISE PROFESIONALE - INXHINIER	SHUMA E SIGURIMIT
AGREGAT	100,000.00 EUR
PJESA E ZBRITSHMË	10% EUR
PRIMI	449.15 EUR
TVSH	80.85 EUR
NË TOTAL:	530.00 EUR

Shënim:

* Periudha e sigurimit është pesë vjeçare (pa mbulim retroaktiv)

** Të gjitha mbulimet i nënshtrohen limiteve, kushteve dhe përjashtimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit. Të gjitha kompensimet u nënshtrohen kushteve dhe përjashtimeve.

KLAUZOLA E MBULIMEVE:

- Gabime në projektim (errors)
- Përjashtime apo lëshime në përgatitjen e dokumentacionit teknik (omissions)
- Neglizhencë profesionale gjatë mbikëqyrjes apo zbatimit të punimeve
- Shkelje të standardeve teknike që sjellin pasoja financiare apo dëme për palët e treta

KLAUZOLA E PERJASHTIMEVE:

- Veprime të qëllimshme apo mashtruese
- Dëme që rrjedhin nga veprimtari jashtë fushës së licencës
- Ndërtime pa leje ose në shkelje të ligjit
- Projekte të jashtme që nuk janë të deklaruar në fillim të policës
- Përgjegjësi penale (sigurimi mbulon vetëm aspekte civile/financiare)

Kërkesa për dëmshpërblim duhet të bëhet brenda periudhës aktive të policës, edhe nëse gabimi ka ndodhur më herët. Pra, policia nuk ofron mbulim retroaktiv.

Për t'u informuar në detaje rreth mbulesës siguruese apo për informata shtesë rreth produkteve të SCARDIAN Sigurime, ju lutemi të na kontaktoni.

Që oferta të jetë valide, klienti duhet të:

Faleminderit në bashkëpunim !

Me respekt,
SCARDIAN Sigurime



Kushtet e Përgjithshme të Policës së Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale

Parathënie

Në marrjen në konsideratë të pagesës së Primit dhe në mbështetje të përmbajtjes së propozimit të cilin e ka ofruar i Siguruari, Ne pajtohem të ofrojmë dëmshpërblimin që i nënshtrohet kushteve të Policës.

Seksioni 1 – Klauzolat e Sigurimit

1.1 Shkelja e Detyrës Profesionale

Ne pajtohem të dëmshpërblejmë të Siguarin ndaj çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim për përgjegjësi civile që del nga shkelja e detyrës profesionale në administrimin e Biznesit Profesional e cila fillimisht është bërë ndaj të Siguarit gjatë Periudhës së Sigurimit të cekur në Policën e Sigurimit.

1.2 Kostoja Mbrojtëse

Ne pajtohem të paguajmë Koston Mbrojtëse të dala nga i Siguruari me pajtim paraprak me shkrim nga ana e jonë gjatë investigimit, mbrojtjes ose marrëveshjes të çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim nën këtë Policë.

Seksioni 2 – Limiti i Përgjegjësisë

2.1 Limiti i Përgjegjësisë

2.1.1 Totali ynë i përgjegjësisë nën këtë Policë për çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim nuk duhet të tejkaloj Limitin e Përgjegjësisë të specifikuar në Policën e Sigurimit .

2.1.2 Totali ynë i përgjegjësisë në shumën totale në lidhje me të gjitha Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim sipas kësaj Police nuk duhet të tejkaloj Limitin e Përgjegjësisë në Limitin agregat në Policën e Sigurimit .

2.1.3 Aty ku Limiti i Përgjegjësisë është i specifikuar të jetë ekskluziv i Kostos së Mbrojtjes, ne Pajtohem, përveç Limitit të Përgjegjësisë, të paguaj Koston e Mbrojtjes të çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim i cili është subjekt i dëmshpërblimit sipas klauzolës të sigurimit 1.1 Me kusht që:

- (a) Aty ku përgjegjësia e të siguarit tejkalon Limitin e Përgjegjësisë në dispozicion, Ne do të paguajmë vetëm atë pjesë të Kostos së Mbrojtjes pasi që Limiti i Përgjegjësisë në dispozicion mbart përgjegjësinë e të Siguarit;
- (b) Aty ku shumën e cilën e Ne e kemi paguar apo e dalë si Kosto e Mbrojtjes tejkalon pjesën që Ne jemi të obliguar të paguajmë sipas 2.1.3(a), i Siguruari duhet në bazë të kërkesës të na paguaj Neve shumën e tejkualuar. Si alternativë, Ne mund të zbrisim shumën e tejkualuar nga ndonjë e drejtë të cilën i Siguruari mund të ketë në çfarëdo kohe sipas kësaj Police.

2.1.4 Aty ku Limiti i Përgjegjësisë në Policën e Sigurimit është i specifikuar të jetë gjithëpërfshirës i Kostos së Mbrojtjes, Ne pajtohem të paguajmë Koston e Mbrojtjes të çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim i cili është subjekt i dëmshpërblimit sipas klauzolës 1.1 ME KUSHT QË totali i përgjegjësisë tonë së bashku me Koston e Mbrojtjes nuk do të tejkaloj Limitin e Përgjegjësisë.

2.2 Grumbullimi i Kërkesave për dëmshpërblim

- 2.2.1 Të gjitha aktet, gabimet dhe lëshimet të cilat janë në çfarëdo mënyre në lidhje me ose që dalin nga një burim ose shkak origjinal do të përbëjnë bashkërisht një akt, gabim ose lëshim të vetëm për qëllime të kësaj Police.
- 2.2.2 Aty ku një akt, gabim ose lëshim i vetëm ngritë më shumë se një Kërkesë për dëmshpërblim, të gjitha Kërkesat për dëmshpërblim do të përbëjnë bashkërisht një Kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj Police, dhe vetëm një Pjesë e zbritshme dhe një Limit të Përgjegjësisë do të aplikohet në lidhje me Pretendimi/Kërkesë për dëmshpërblim në tërësi.

2.3 Pjesa e Zbritshme

- 2.3.1 Vlera/shuma e Pjesës së Zbritshme do të mbulohet nga i Siguruari në riskun e vetë në lidhje me secilën Kërkesë për Dëmshpërblim.
- 2.3.2 Aty ku shuma e çfarëdo Kërkesë për dëmshpërblim është më pak se Pjesa e zbritshme, i Siguruari do të jetë përgjegjës për Kërkesën për dëmshpërblim dhe Koston e Mbrojtjes.
- 2.3.3 Aty ku Pjesa e zbritshme është e specifikuar të jetë e përfshirë në Koston e Mbrojtjes, i Siguruari do të paguaj Koston e Mbrojtjes siç është shkaktuar, deri në shumën e Pjesës së zbritshme.

Seksioni 3 – Përfshirjet

Në nuk do të dëmshpërblejmë të Siguarin sipas këtij seksioni të Policës për çfarëdo Kërkesë për dëmshpërblim që del në mënyrë direkte apo indirekt nga:

3.1 Azbesti

Azbesti

3.2 Përgjegjësia e Supozuar

- (a) Çfarëdo përgjegjësie kontraktuale ose e supozuar, përveç nëse i Siguruari do të jetë në çfarëdo rasti ligjërisht përgjegjës në mungesë të përgjegjësisë të tillë kontraktuale ose të supozuar; ose
- (b) Çfarëdo përgjegjësie të supozuar nga i Siguruari nën çdo sigurim ose garanci.

3.3 Drejtorët dhe Zyrtarët

I siguruari i cili vepron si administrues, drejtor, sekretar ose zyrtar i besimit ose organ i korporatës

3.4 Akte të pandershme ose të Pamatura

Çfarëdo veprimi aktual ose i supozuar:

- (a) Akte të pandershme, mashtruese, kriminale ose qëllimkeq;
- (b) Shkelje me dashje të ndonjë statuti, kontrate ose detyre; ose
- (c) Sjellje me mospërfillje të pamatur për pasojat të dala nga kjo, nga i Siguruari.

3.5 Përgjegjësia e Punëdhënësit

Ose të bazuar, që atribuon, ose si pasojë e përgjegjësisë të Siguarit si punëdhënësi, përfshirë Lëndimin Personal të ndonjë personi që del gjatë punësimit të tyre me të Siguarin (ose si Punëtor i të Siguarit ose si kontraktues i të Siguarit).



Me qëllim të këtij Përjashtimi të Lëndime Personale do të nënkuptoj lëndime personale, sëmundje, ose vdekje të ndonjë personi përfshirë por jo limituar në lëndim mental, ankth, stres, shqetësim emocional ose shok nervor.

3.6 Shërim pa Pagesë

Çfarëdo rimbursimi ose tarife, ose për dëmet e kalkuluara në lidhje me, çfarëdo tarife ose ngarkese ose që del nga i Siguruari.

3.7 Gjobat, Dënimet dhe Dëmet

Ose për dhënien e ndonjë dënimi, dëmeve të likuiduara, dëmeve ndëshkuese, dëmeve karakteristike, dëmeve që rëndojnë, ose dëmeve tjera të pa kompensuara të çfarëdo lloji.

3.8 Falimentim

Ose që del nga falimentimi i të Siguararit, falimentim, likuidim, ose dështim për të paguar ndonjë borxh të tregtisë.

3.9 Menaxheri i Sigurimit

I Siguruari i cili vepron si menaxher i kompanisë së sigurimit ose nga falimentimi i kompanisë së sigurimit.

3.10 Juridiksioni dhe Limitet Territoriale

- (a) Çfarëdo akti aktual apo të supozuar, gabim ose lëshim brenda limiteve territoriale të Republikës së Kosovës, ose
- (b) I cili është sjellë në gjykatë brenda limiteve territoriale të Republikës së Kosovës, në mënyrë direkt apo indirekte, që del nga ndonjë marrëveshje ose për zbatim të aktgjykimi ose urdhri të marr brenda limiteve territoriale, ose të vendosur në përputhje me ligjet e këtyre vendeve ose territoreve ose protektorateve.

3.11 Përgjegjësia e Banuesit

Çfarëdo okupimi ose pronësie ose menaxhim të ndonjë prone të prekshme nga i Siguruari.

3.12 Dukuria e Pretendimeve të Bëra

Fakti që i Siguruari ka aranzhuar ose kërkuar të aranzhohet një përgjegjësi e përgjithshme ose publike e kontraktuar të sigurimit e cili i përgjigjet një Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim në Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim e bëra në bazë të PËRVEÇ NËSE, para hyrjes në kontratën e sigurimit, i Siguruari këshillon klientin e tij/saj me shkrim që ai/ajo mund të mos jetë i/e siguruar në lidhje me Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim në bërë kundër tyre pas skadimit të kontratës së sigurimit që del nga ngjarjet të cila dalin gjatë periudhës së sigurimit të kontratës KU i siguruari ka, pas skadimit të kontratës, ka hyrë në një përgjegjësi të përgjithshme ose publike të kontraktuar të sigurimit e cila i përgjigjet Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim në bazë të paraqitjes.

3.13 Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim Paraprake ose Rrethanat

- 3.13.1 Çfarë do Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim i bërë, i kërcënuar ose në ndonjë mënyrë tërthorazi ndaj të Siguararit para Periudhës së Sigurimit; ose



3.13.2 Që atribuohet ndaj ose si pasojë e ndonjë fakti apo rrethane:

- (a) Për të cilin njoftimi me shkrim është dhënë nën ndonjë dëmshpërblim të mëparshëm profesional ose ndonjë policë tjetër të sigurimit;
- (b) I shënuar në propozimin për Periudhën aktuale ose ndonjë propozim të mëhershëm; ose
- (c) Për të cilin i Siguruari ka qenë fillimisht i njoftuar para Periudhës së Sigurimit dhe për të cilin i Siguruari ka qenë në dijeni ose duhet të ketë ditur mund të ngritë një Pretendim;

3.14 Radioaktiviteti

I shkaktuar nga ose i kontribuar nga rrezatimi jonizues ose kontaminimi nga radioaktiviteti nga ndonjë karburant nuklear, armë, izotope medicinave, mbeturina ose materiale tjera që kanë ndodhur në mënyrë natyrale ose e kundërta, ose nga eksplozivi toksik radioaktiv ose si pasojë e ndonjë eksplozioni të stabilimentit nuklear ose komponentit nuklear të saj.

3.15 Subjektet e Ndërlidhura

Të sjella ose të mirëmbajtura nga, ose në emër të:

- (a) Të cilitdo person të siguruar; ose
- (b) Të ndonjë personi i cili/e cila, në kohën e aktit, gabimit ose lëshimit që ngrit Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n, është Anëtar i Familjes i të Siguarit; ose
- (c) Të ndonjë subjekti i operuar ose kontrolluar nga ndonjë i Siguar ose Anëtar i Familjes i të Siguarit.

3.16 Të Drejtat e Kthimit

Çfarëdo detyrimi, humbje apo dëmtimi në lidhje me të cilin i Siguruari i është shmangur, i përjashtuar ose i është limituar e drejta e kthimit.

3.17 Nënshkrimi i Propozimit

Ose në lidhje me ndonjë policë të sigurimit të bazuar në një aplikacion ose propozim i nënshkruar nga i Siguruari.

3.18 Terrorizmi

I shkaktuar ose që shkaktohet ose që ndodh nëpërmes ose si pasojë e terrorizmit ose ndonjë veprim i ndërmarr për kontrollimin, parandalimin, shtypjen e ndonjë akti ose akteve terroriste ose në ndonjë mënyrë të lidhur me atë.

Për qëllim të kësaj Klauzole "terrorizëm" do të thotë çfarëdo akti ose akte (të kërcënuar ose aktual) të ndonjë personi ose personave të përfshirë në shkaktimin ose kërcënimin për të shkaktuar dëme të çfarëdo natyre dhe me çfarëdo mjeti ose Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim në tërësi ose pjesërisht për qëllime politike, religjioze, ideologjike ose të ngjashme.

3.19 Lufta

Ose e shkaktuar nga lufta, pushtim, akte të armikut të huaj, veprime ushtarake (e shpallur apo jo), luftë civile, revolucione, kryengritje, me fuqi ushtarake apo uzurpim ose konfiskimi ose nacionalizimi ose me



kërkesë ose shkatërrim ose dëme në pronë nga ose nën urdhrat e ndonjë qeverie ose autoriteti publik ose lokal.

3.20 Siguruesit e Paautorizuar

Dështimi i një siguruesi të paautorizuar të përmbush obligimet e tij/saj sipas kontratës të sigurimit.

3.21 Shpifja

Çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim për shpifje të paqëllimshme, përgojim apo shpifje.

3.22 Të Drejtat e Pronës Intelektuale

Çfarëdo Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim që del nga:

- (a) Shkelja e të drejtave të autorit, markave tregtare, dizajneve të regjistruara, patentave, plagjiaturës; ose
- (b) Përcjellja; ose
- (c) Shkelja e konfidencialitetit.

3.23 Shkelja e Detyrave të Mirëbesimit

"shkelja e detyrës profesionale" përfshinë shkeljen e detyrës të mirëbesimit që i detyroheni klientëve të Siguruar.

3.24 Konsulentët, Kontraktuesit & Agjentët (Përgjegjësia e Deleguar)

Çfarëdo përgjegjësie, humbje ose dëmtim të ndonjë Klienti që del nga puna e ndërmarr nga konsulentët, kontraktuesit ose agjentët e caktuar nga i Siguruari.

3.25 Ndërmarrjet e Përbashkëta

Çfarëdo detyrimi, humbje apo dëmtim që del nga pjesëmarrja e të Siguruarit në ndonjë ndërmarrje të përbashkët në lidhje me Biznesin Profesional.

3.26 Humbja e Dokumenteve

Çfarëdo detyrimi, humbje ose dëmtimi ose shpenzim që del nga humbja e dokumenteve.

3.27 Besnikëria

Çfarëdo detyrimi, humbje ose dëmtim për ndonjë humbje të parave, instrumenteve të negociuara, bonove bartëse ose kuponëve, pullave, shënimeve të bankave ose të monedhave nën kujdesin e të Siguruarit, kujdestari ose kontroll i cili i përket të Siguruarit ose për të cilin i Siguruari është përgjegjës ligjërisht, të cilin i Siguruari e mban si rezultat të ndonjë akti të pandershëm ose mashtrues të ndonjë Punëtori të Siguruar dhe të përkushtuar në kryerjen e Biznesit Profesional të Siguruarit.

3.28 Bizneset e Kaluara

Çfarëdo detyrimi, humbje ose dëmtim që del nga bizneset dhe/ose aktivitetet tuaja të kaluara.

Seksioni 4 – Kushtet e Përgjithshme



4.1 Ndryshimi i Biznesit Profesional të Siguruarit

I Siguruari duhet të na njoftoj Neve me shkrim brenda 7 ditëve për ndonjë ndryshim material të Biznesit Profesional të Siguruarit, përfshirë por jo limituar në:

- (a) Ndonjë ndryshim material të bërë ose lejuar nga i Siguruari në natyrën e Biznesit Profesional të Siguruarit;
- (b) Ndonjë përvetësim nga i Siguruari, ose bashkim të Siguruarit, ndonjë biznes tjetër, qoftë ose jo të natyrës së njëjtë si Biznesi Profesional i të Siguruarit;
- (c) (qoftë i Siguruari person fizik) i Siguruari falimenton ose hyn në marrëveshje të borxhit, ose
- (d) (qoftë i Siguruari kompani apo trup i korporatës) caktimi i një administratori, pranuesi, likuidator i përkohshëm. Ose likuidator i të Siguruarit;
- (e) Regjistrim statutor i të Siguruarit ose regjistrim i anuluar me shoqata të tyre profesionale, e suspenduar ose ka kushte të imponuara.

4.2 Caktimi i Interesit

Asnjë ndryshim, modifikim ose caktim i ndonjë interesi sipas kësaj Police nuk duhet të ketë efekt në ligj përveç nëse bëhet me aprovim Tonin me shkrim.

4.3 Anulimi

I Siguruari mund të anuloj këtë Policë në çdo kohë duke na njoftuar Ne me shkrim. Ne mund gjithashtu të anulojmë këtë Policë, por Ne mund ta bëjmë atë vetëm në përputhje me ligjin. Në rast të anulimit dhe subjekt të ndonjë kërkesë ligjore, ndonjë rimbursim të Primit dhe shuma e rimbursimit do të jetë në diskrecion Tonin të vetëm.

4.4 Taksat

Qoftë nën këtë Policë Ne jemi të obliguar të dëmshpërblejmë të Siguruarin ndaj ndonjë Pretendimi/Kërkesë për dëmshpërblim ose Kosto Mbrojtëse për të cilën i Siguruari ka të drejtë në një taksë, shuma e të cilës taksë do të zbritet nga ndonjë pagesë të paguar nga Ne.

4.5 Përpilimi i Policës, Interpretimi dhe Njoftimet

- 4.5.1 Përpilimi, interpretimi dhe domethënia e termeve të kësaj Police do të përcaktohen në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. Çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me Policën do ti parashtrahet juridiksionit ekskluziv të gjykatave në territorin e Republikës së Kosovës.
- 4.5.2 Titujt në këtë Policë janë përfshirë vetëm për qëllime përshkruese dhe nuk janë pjesë formuese të kësaj Police për qëllime të përpilimit ose interpretimit të saj.
- 4.5.3 Në këtë Policë fjalët e përdorura në njëjës duhet të përfshihen edhe në shumës dhe e kundërta.
- 4.5.4 Çfarëdo njoftimi të cilin Ne ose i Siguruari jemi të obliguar ose e përzgjedhim të japim sipas kësaj Police, mund të jepet tjerëve ose nga Ne.

4.6 E Pjesshme dhe Jo – Imputim

- 4.6.1 Aty ku i Siguruari është më shumë se një person ose entitet dhe një ose më shumë të këtyre personave ose entiteteve:



- (a) Dështojnë ti përmbahen me detyrën e zbulimit;
 - (b) Ka bërë keqinterpretimin tek Ne para se është hyrë në këtë Policë; ose
 - (c) Ka dështuar ti përmbush kushtet e kësaj Police;
- E drejta e personit tjetër ose entitetit të dëmshpërblehet sipas kësaj Police nuk duhet të prejudikohet si rezultat i ME KUSHT QË të personit tjetër ose entitetit;
- i. Ka vepruar në mirëbesim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të tij/saj edhe sipas kësaj Police por edhe sipas ligjit;
 - ii. Është krejtësisht i pafajshëm, nuk ka pasur dijeni paraprake, ose nuk ka pasur shkak të ketë njohuri për sjelljen përkatëse, (për qëllime të kësaj klauzole, njohuria e dhënë personit me arsye të partneritetit ose tjetër duhet të mos përfillet); dhe
 - iii. Na njofton me shkrim për të gjitha faktet e njohura sa më parë që është praktike me të qenit i vetëdijshëm për këtë sjellje;

4.6.2 Kjo klauzolë nuk duhet të përdoret për të rritur Limitin e Përgjegjësisë siç është deklaruar në Policën e Sigurimit .

Seksioni 5 – Kushtet e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t

5.1 Raportimi i Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t

I Siguruari duhet të Na jap njoftimin me shkrim sa më parë që është praktike dhe gjatë Periudhës së Sigurimit, për ndonjë Kërkese për dëmshpërblim të bërë ndaj të Siguarit.

5.2 Mbrojtja dhe Zgjidhja

- 5.2.1 Ne do të kemi të drejtë në çdo kohë të ndërmarrim dhe të drejtojmë, në emër të Siguarit, mbrojtjen dhe zgjidhjen e ndonjë Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim . Avokatët tonë do të veprojnë në emër të Siguarit do të kenë të drejtën në çdo kohë të na njoftojnë për ndonjë informatë ose dokument të pranuar (qoftë nga i Siguruari ose e kundërta) për të vepruar dhe i Siguruari pajtohet tërheq dorë nga ndonjë Kërkese për dëmshpërblim për klientin në masë që privilegji i tillë ligjor në të kundërtën mund të parandaloj atë dhënie të informatave tek ne.
- 5.2.2 I siguruari nuk duhet të zgjidh ndonjë Pretendim, të shkaktoj ndonjë Kosto të Mbrojtjes, të bëjë ndonjë pranim, të ofroj ndonjë pagesë, ose të hyjë në ndonjë obligim kontraktues në lidhje me ndonjë Kërkese për dëmshpërblim pa miratimin Ton me shkrim (i cili miratim nuk do të refuzohet pa arsye). Ne nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë zgjidhje, Kosto të Mbrojtjes, pranim, ofertë apo pagesë, ose obligim të marr për të cilin Ne nuk e kemi miratuar me shkrim.
- 5.2.3 Aty ku, në mendimin tonë, ndonjë Kërkese për dëmshpërblim nuk ka tejkaluar Pjesën e zbritshme, ne do të kemi të drejtë të kërkojmë nga i Siguruari të kryej mbrojtjen e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t. Në këtë situatë:
- (a) I siguruari duhet të na këshilloj me shkrim për të gjitha zhvillimet në lidhje me mbrojtjen dhe vendosjen e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t siç ka ndodhur;
 - (b) I Siguruari mund të vendos Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t pa miratimin tonë ME KUSHT QË ai/ajo nuk do të kërkoj dëmshpërblim sipas kësaj Police në lidhje me Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n; dhe
 - (c) Kur është e qartë se Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim do të ketë Pjesë të zbritshme, Ne kemi të drejtë të marrim përsipër dhe të administrojmë, në emër të



Siguruarit, mbrojtjen ose vendosjen e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t, dhe Ne do të rimbursojmë Koston e Mbrojtjes të arsyeshme të dalë deri atëherë nga i Siguruari.

5.2.4 Aty, sipas opinionit tonë, ku detyrimi i ndonjë Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim mund të kaloj limitin në dispozicion të detyrimit, ne do të kemi të drejtë në diskrecion të shlyejmë obligimin tonë duke paguar limitin në dispozicion të detyrimit të Siguararit ose në emër të tij/saj dhe të paguajmë Koston e Mbrojtjes deri në atë datë të pagesës. Në këtë situatë:

- (a) Nëse në kohën e pagesës Ne duke administruar mbrojtjen e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t, Ne gjithashtu heqim dorë nga ai administrim; dhe
- (b) Kushtet e Policës 2.1.3 do të jenë ende të aplikueshme.

5.2.5 I Siguruari duhet, kur i është këshilluar nga Ne, të paguaj menjëherë brenda kushteve të ndonjë marrëveshje të propozuar shumë e Pjesës së zbritshme. Nëse i siguruari dështon ose refuzon ta bëjë pagesën dhe Ne vendosim ta bëjmë pagesën në emër të Siguararit, Ne kemi të drejtë të zbrisim shumë nga ndonjë e drejtë që i Siguruari mund të ketë në çdo kohë sipas kësaj Police.

5.3 Të Drejtat e të Siguararit për të Kontestuar një Kërkese për dëmshpërblim

Në rast që Ne rekomandojmë një marrëveshje të ndonjë Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim por i Siguruari nuk pajtohet me rekomandimin Ton, i Siguruari mund të zgjedh të kontestoj Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n ME KUSHT QË detyrimi aktual për Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n tejkalon shumë për të cilën, por për zgjedhjen e të Siguararit, Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim mund të jetë përmbushur, atëherë:

- (a) Detyrimi Jon për Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n do të jetë shuma për të cilën, por për zgjedhjen e të Siguararit, Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim mund të jetë përmbushur; dhe
- (b) Kostoja e Mbrojtjes e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t do të jetë Kostoja e Mbrojtjes e dalë nga miratimi jonë paraprak me shkrim deri në datën e zgjedhjes së Siguararit.

5.4 Drejtat Tona për të Kontestuar një Kërkese për dëmshpërblim

I Siguruari nuk do të ketë nevojë të kontestoj Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n përveç nëse një Këshilltar i Lartë (i caktuar nga Ne) e këshillon që Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim duhet të kontestohet. Në formulimin e asaj këshille, Këshilltari i Lartë do të marr në konsideratë çështjen, që detyrimi së bashku me Koston e Mbrojtjes dhe shanset për mbrojtjen e Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t me sukses. Kostoja e këshillës së Këshilltarit të Lartë do të merret si pjesë e Kostos së Mbrojtjes.

5.5 Lehtësimi i Pretendimeve dhe Bashkëpunimi

- 5.5.1 I Siguruari duhet të përdorë kujdes të duhur dhe të kryej me vëmendje të gjitha gjërat e arsyeshme dhe praktike në mënyrë që të shmang, minimizoj ose lehtësoj ndonjë detyrim, humbje apo dëme që është ose mund të jetë subjekt i Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim t.
- 5.5.2 I Siguruari duhet të prezantoj tek Ne me sinqeritet të gjitha informatat relevante, dhe ofroj të



- gjitha informatat dhe asistencën që Ne mund ta kërkojmë për të hulumtuar dhe mbrojtur Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim n, të përcaktoj nëse i Siguruari ka të drejtë të dëmshpërblehet sipas kësaj Police, ose të ndjekë penalisht për ndonjë veprim të kompensimit.
- 5.5.3 Në përputhje me klauzolat 5.5.1 dhe 5.5.2 do të jetë në shpenzim të Siguararit përveç nëse është dakorduar për këtë me shkrim nga Ne.

Seksioni 6 – Definicionet

6.1 Pretendimi/Kërkese për dëmshpërblim

"Pretendim" do të thotë:

- (a) Pranimi nga i Siguruari të një kërkesë për kompensim të bërë nga pala e tretë ndaj tij/saj.
Duhet të jetë në formën në vijim:
 - (i) Me shkrim, deklaratë e Pretendimi/Kërkesa për dëmshpërblim, ftesë, aplikacion ose proces tjetër ligjor ose arbitrar, pretendim, kundër Kërkesë për dëmshpërblim ose palë e tretë ose e ngjashme; ose
 - (ii) Ndonjë formë tjetër e njoftimit me shkrim ose verbal; dhe ku është e aplikueshme
- (b) Përpilimi nga i Siguruari të Pretendimi/Kërkesë për dëmshpërblim t kundër Nesh sipas zgjerimeve automatike 1.10 (Kostoja e hetimit zyrtar), 1.1.6 (Humbja e Dokumenteve) dhe zgjerimi opsional 1.1.7 (besnikëria).

6.2 Kostoja e Mbrojtjes

"Kostoja e Mbrojtjes" do të thotë kosto e shkaktuar nga Ne, ose për një kosto të arsyeshme të dal nga i Siguruari me miratim paraprak me shkrim, në hulumtimin, mbrojtjen, raportimin ose negocimin për marrëveshjen në lidhje me ndonjë Pretendim. Kjo nuk duhet të përfshijë ndonjë kosto të palës që pretendon ndaj të Siguararit.

6.3 Dokumente

"Dokumente" përfshinë dokumente të çfarëdo natyre, të shkruar, të shtypur ose riprodhuar nga ndonjë metodë përfshirë të dhëna kompjuterike dhe të dhëna elektronike materiale POR NUK DO TË PËRFSHIJË para, instrumente të negociuara, bono bartëse ose kupon, pulla, shënime ose monedha bankare ose ndonjë instrument tjetër të negociuar.

6.4 Punëtori

"Punëtori" do të thotë cilido person i punësuar sipas një kontrate të shërbimit ose praktikës por nuk do të thotë një konsulent, kontraktues ose ndërmjetësues.

6.5 Pjesa e zbritshme

"Pjesë e zbritshme" do të thotë shuma e specifikuar si Pjesë e zbritshme në Policën e Sigurimit .

6.6 Anëtar i Familjes

"Anëtar i Familjes" do të thotë:



- (a) Bashkëshorti/bashkëshortja, partner ose shoqërues;
- (b) Cilido prind, prind i bashkëshortit/bashkëshortes, partner ose shoqërues; ose
- (c) Vëlla ose motër, fëmijë, fëmijë i adoptuar i cili jeton me personin nëse fëmija është anëtar i familjes së personit.

6.7 I Siguruar

"I Siguruar" do të thotë:

- (a) Personi, personat, partnerët, kompania, korporata, autoritetit statutorë ose entitet tjetër i specifikuar në Policën e Sigurimit si i Siguruar;
- (b) Çdo paraardhës në biznes të ndonjë personi ose entitetin (a);
- (c) Çdo person i cili është, ishte, bëhet ose nuk do të jetë më kryesor, partnerë, drejtor ose Punëtor të ndonjë personi, personave, partnerëve, kompanisë, korporatës, autoritetit statutorë ose ndonjë entiteti tjetër në Policën e Sigurimit si i Siguruar, por në secilin rast të vetëm në lidhje me detyrimin që del nga aktiviteti dhe në emër të atij entiteti; dhe
- (d) Çdo ekzekutor, trashëgues ose kujdestar të ndonjë personi në (a), (b) ose (c).

6.8 Limiti i Përgjegjësisë

Limiti i Përgjegjësisë do të thotë maksimumin e shumës së paguar tek Ne në lidhje me një Kërkesë për dëmshpërblim të bërë nga çdokush.

6.9 Limiti i Përgjegjësisë në Total

"Limiti i Përgjegjësisë në Total" do të thotë maksimumin e shumës së paguar nga Ne për të gjitha Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim sipas kësaj Police.

6.10 Periudha e Sigurimit

"Periudha e Sigurimit" do të thotë periudhën e specifikuar në Policën e Sigurimit .

6.11 Polica

"Polica" do të thotë:

- (a) Klauzolat e Sigurimit, vazhdimet, përjashtimet, kushtet;
- (b) Definicionet, Tabelat dhe kushtet tjera të dhëna këtu;
- (c) Çdo miratim të kësaj Police të lëshuar ose nga fillimi i kësaj Police ose gjatë periudhës së Sigurimit;
- (d) Informatat e ofruara nga i Siguruari në Propozim.

6.12 Primi

"Primi" do të thotë primi i specifikuar në Policën e Sigurimit .

6.13 Biznesi Profesional



"Biznesi Profesional" do të thotë biznesi ose profesioni i specifikuar në Policën e Sigurimit dhe i ushtruar nga i Siguruari.

6.14 Propozimi

"Propozimi"

Nënkupton propozimin me shkrim nga i Siguruari që na drejtohet neve që përmban informata dhe deklarata të cilat, së bashku me ndonjë informatë tjetër ose dokumente të ofruara, janë bazë e kësaj Police dhe konsiderohen të përfshira në të.

6.15 Tabela

"Tabela" nënkupton Policën e Sigurimit të kësaj Police.

6.16 Ne, e Jona, Neve

"Ne", "e Jona" ose "Neve" nënkupton SCARDIAN Sigurime

Përfshirjet

Kjo policë nuk do të mbulojë ndonjë Kërkesë për dëmshpërblim që del nga:

1. Ndonjë akt të neglizhencës, gabimit ose lëshimit në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e kryera që dalin përtej vëllimit të shërbimeve profesionale sipas legjislacionit vendor, kodit etik dhe rregullave;
2. Ndonjë aranzhimi ose rekomandimi – qoftë kjo pa para ose jo – çështje financiare, të pronës ose çështje tjera komerciale, kjo nuk do të aplikohet nëse, dhe përderisa, Pretendimi/Kërkesë për dëmshpërblim del nga këshillë e rreme për çështje të taksave;
3. Ndonjë interpretim i gabuar ose aplikimi ose mos vërejtja e dispozitave të huaja ligjore;
4. Pjesa e zbritshme e cekur në policën e sigurimit
5. Çfarëdo shume që tejkalon shpenzimin e paraparë apo linjën kreditore;
6. Ndonjë gabim ose shkelje e obligimeve në lidhje me kontabilitet ose transferimeve financiare ose që dalin nga shpërdorimi i punëtorëve të Siguarit;
7. Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim që dalin nga aktivitetet e të Siguarit si kryesues ose anëtar i Bordit Menaxhues ose Bordit Mbikëqyrës të ndërmarrjeve private, klubeve, asociacioneve ose si zyrtar ligjor i tyre;
8. Shpifje ose përgojim;
9. Çdo neglizhencë, gabim ose lëshim nga i Siguruari që ka ndikim ose në mirëmbajtje të sigurimit;
10. Falimentim i të Siguarit;



11. Humbje e dokumenteve (të çfarëdo qoftë natyre) qoftë me shkrim, e shtypur ose e riprodhuar nga çfarëdo metode ose e bazuar në kompjuter ose informata të ruajtura elektronike ose pronë materiale e cila është humbur, e harruar ose shkatërruar deri sa ishte në posedim, ose në ruajtje, kujdestari ose kontroll të Siguruarit;
12. Çdo akt i qëllimshëm, i pandershëm, qëllim keq, kriminal ose ilegal nga i Siguruari ose punëtorët e tij;
13. Lëndim trupor, dëmtim i pronës ose humbje konsekuente që rezulton nga ajo;
14. Çdo humbje financiare e drejtpërdrejt, indirekt ose të dyshuar që është shkaktuar nga ose e kontribuar nga, ose që del nga, ndotja e ajrit, ujit ose tokës;
15. Çdo pasojë e luftës, pushtim, aktit të armikut të jashtëm, veprimeve ushtarake (qoftë luftë e shpallur apo jo), luftë civile, terrorizëm, rebelim, revolucion, kryengritje ose ushtarake, ose fuqi uzurpuese;
16. Dënimet, penalltitë, dëme ndëshkuese ose karakteristike ose dëme tjera që rezultojnë nga shumëzimi i dëmeve kompenzuese;
17. Obligime të supozuara nga i Siguruari nga kontraktuesi ose ndonjë marrëveshje tjetër (përfshirë: ndonjë garanci të shprehur apo nënkuptuar ose garanci), përveç nëse detyrimi i tillë do të bashkëngjitet në mungesë të kontratës apo marrëveshjes së tillë;
18. Pretendimet /Kërkesat për dëmshpërblim e parashtruara nga i Siguruari sipas kësaj police ndaj njëri tjetrit ose e menaxhuar nga ndonjë palë:
 - E cila është drejtpërdrejt ose indirekt në pronë, e kontrolluar, e operuar ose menaxhuar nga i Siguruari;
 - Në të cilën i Siguruari është partner, konsulent ose punëtor ose familjarë (përfshirë: bashkëshort/bashkëshorte).

